



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-17013/20
Kaçanik, 03.08.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI-të** (Gashtë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 03 Gusht 2020. Për shkak të distancës fizike lidhur me pandeminë Covid-19, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani dhe Festim Neziraj.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI-të (Gjashtë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 03 Gusht, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti gjashtëmujo financiar, për periudhën: Janar-Qershor 2020; dhe
3. Raporti i Punës së KKSBB –së për 6 mujorin e parë 2020.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së V-të (Pestë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 16 Korrik 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-12856/20.

2. Raporti gjashtëmujor financiar, për periudhen: Janar-Qershor 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Raportin financiar e keni marrë, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të tabela me Nr. 1, shihet së është një disbalancë e madhe e shpenzimeve të Grantit Qeveritar(GQ) në raport me të HVK. Nga raporti shihet së GQ është shpenzuar 39.11%, ndërkaq të HVK janë shpenzuar vetëm, 7.53%.

Të pozicioni, Mallrat dhe Shërbimet, kemi ngritje të shpenzimeve, këtu sigurisht kanë hyrë edhe shpenzimet prej 100.000€ për parandalimin e pandemisë Covid-19.

Të inkasimi i mjeteve buxhetore, kemi ngecje të DBPZHR të ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ndërkaq nuk ka të hyra nga shfrytëzimi i resurseve natyrore.

Të shpenzimet e realizuara, kemi rënie të shpenzimeve të kategoria investimeve kapitale dhe të kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Të shpenzimet për subvencione dhe transfere, realizimi i mjeteve buxhetore është shumë i vogël, ndërkaq nevojat për subvencione janë të mëdha qoftë në shëndetësi, bujqësi apo në fusha të tjera. Të Investimet kapitale, edhe në këtë program shpenzues buxhetor, nga raporti shihet së shpenzimet janë të vogla, shpresojmë që këto shpenzime të rriten në muajt e mbetur të këtij viti, në mënyrë që mos të ngelin mjete në suficit. buxhetorë.

z. Selim Reka, Nga raporti financiar shihet së ka dallime të implimentimi i buxhetit në programe të caktuara shpenzuese buxhetore, të granet buxhetore, si të sektori i shëndetësisë, ashtu të sektori i arsimit. Të hyrat vetanake komunale (HVK) të Tatimi në pronë, janë realizuar 42.13 %, e që në raport me vitin e kaluar shihet së kemi ulje të inkasimit të mjeteve në këtë program buxhetor. Ngecje të inkasimit të mjeteve buxhetore kemi të rexhistrimi i autoveturave, ndërkaq të taksat nga ushtrimi i veprimtarisë është një ngritje e vogël, ulje ka të gjobat nga inspektorati, taksat tjera, ndërkaq nuk kemi të hyra nga licencat për pranim teknik të lokalit. Të shpenzimet e realizuara, shqetësuese janë programi për subvencionet dhe transferet të cilat shpenzime janë realizur në shumë të vogël, ndërkaq dihen nevojat e qytetarëve të komunës për subvencione. Gjithashtu shpenzimet të Investimet kapitale janë të vogla, për kundër arsyeve, shpresojmë që këto shpenzime të rriten në muajt e mbetur të këtij viti, në mënyrë që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit. Të shpenzimet komunale nga raporti shihet së kemi rritje të shpenzimeve të mbeturinat dhe të energjia elektrike. Gjithashtu rritje të shpenzimeve kemi edhe të pozicioni: Mallra dhe shërbimet, sigurisht kjo për shkak të ndarjes së mjeteve buxhetore për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

z. Ekrem Kyçyku, Të pagesat e shërbimeve gjyqësore, me intereson të di, Sa është shuma e mjeteve të paguara dhe nga cilat kategori janë marrë mjetet buxhetore për ekzekutimin e këtyre pagesave ?

z. Bahri Selimi- Drejtor i DEFZH, Kur jemi të realizimi i buxhetit 2020, buxheti është realizuar 36.08%, e që në krahasim me vitin e kaluar kemi shkallën e shpenzimit për 6% progres. Të MSH ka rritje të shpenzimeve për shkak të lejimit të mjeteve buxhetore-fondit emergjent për parandalimin e pandemisë Covid-19 si dhe ekzekutimin e vendimeve të

gjykatave nga kjo kategori ekonomike. Të Vendimet e gjykatave, kemi mjete të marra nga MSH që janë borgje të vitit të kaluar, disa konteste janë edhe të DAK që na i kanë marrë mjetet me përmbarues privat. Të Investimet kapitale të tabela analitike janë të dhënat ku janë tërhequr mjetet për lëndë përmbarimore. Në vazhdim drejtori Selimi dha sqarime për mjetet e tërhequra për lëndë përmbarimore se në cilat pozicione janë marrë mjetet, si nga projektet e turizmit, pastaj janë tërhequr mjetet edhe nga projekti "Rindërtimi i projektit të QMF në Doganaj" shuma 30.000€-53.000€ janë tërhequr nga drejtoritë komunale. Të shpenzimet komunale është një rritje e lehtë, për shkak të shtimit të numrit të faturave të energjisë elektrike për ndriçim publik dhe realizimin e pagesave të faturave të papaguara të vitit të kaluar. Të kategoria e Investimeve kapitale kemi shpenzim më të ulët të mjeteve buxhetore, për arsye të pagesave për iniciimin e procedurave të prokurimit dhe mungesës së alokimit të mjeteve buxhetore nga niveli qendror për shkak të pandemisë Covid-19. Të Subvencionet dhe transferet, ka rënie të shpenzimeve për disa aktivitete të rregullta kultrore e sportive të cilat nuk janë zhvilluar. Për shkak të pandemisë Covid-19, buxhetin e kanë zvogëluar këta faktorë: mosndalja e kamatave, mos shqiptimi i dënimeve dhe mungesave e mërgimtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që raporti financiar t'i procedohet Kuvendit të Komunës? Për votuan të gjithë anëtarët e KPF, kështuqë konstatohet së KPF vendosi që,

Raportin gjashtëmuor financiar për periudhen: Janar-Qershor 2020, t'ia kaloj Kuvendit të Komunës në formë informate.

3. Raporti i Punës së KKSBB –së për 6 mujorin e parë 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Raportin e KKSBB e kani marrë, nëse ka kush që don mer marrë fjalën lë të urdhëroj:

z. Selim Reka, Unë kam një kërkesë për KKSBB lidhur me autoveturat të cilat po parkohen nepër trotuare e rrugë, me çka po i bllokojnë rrugët dhe trotuaret, me çka po vështirsojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve. Kërkoj nga Kryetari i Komunës të inicon këtë çështje në KKSBB, në mënyrë që të merren veprime të nevojshme nga organet relevante (Policia e Kosovës dhe Inspektorët) që mos me u bërë parkimi i veturave nepër rrugë e trotuare.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, a jeni të pajtimit që Raporti i KKSBB t'i adresohet Kuvendit të Komunës. Për me ia kaluar Kuvendit të Komunës Raportin e punës së KKSBB votuan njëzëri të gjithë anëtarët e KPF. Në saje të kësaj del konstatimi së; KPF vendosi që,

Raporti i Punës së KKSBB –së për 6 mujorin e parë 2020, i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë në formë informate.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:23. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 12 Gusht 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli

